

Barometri politik 1/2008

Projekt afagjatë i hulumtimit të opinionit publik rreth gjendjes dhe ngjarjeve aktuale politike në Kosovë

Lulzim Pllana*

Hyrje

Barometri politik është projekti i parë hulumtues me tematikë politike i inicuar nga Universiteti AAB, më saktësisht nga Qendra për Hulumtimin e Opinionit - QHO. Ky hulumtim i parë eksperimental financohet nga Universiteti AAB dhe realizohet në bashkëpunim me Universitetin e Lubjanës, Qendrën për Hulumtimin e Opinionit Publik dhe të Komunikimit Masiv të këtij universiteti.¹

Në periudhën kohore prej 4 deri më 6 dhjetor, në bazë të pyetësorit të standardizuar e anonim dhe metodës „Face-to-face“, u zhvillua anketimi në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në zonat e Prishtinës, Gjilanit, Ferizajt, Prizrenit, Gjakovës, Pejës dhe Mitrovicës, duke përfshirë këtu edhe vendbanimet me shumicë të nacionaliteteve të tjera. Shpërndarja e pyetësorve është bërë sipas numrit të vendbanimeve të Entit të Statistikave të Kosovës.² Nga 880 persona të paraparë, janë anketuar 876 (99%) persona me të drejtë vote, çka e bën projektin të jetë reprezentativ. Anketimi nëpër komunat apo, më saktësisht, pikat anketuese, është kryer nga 30 anketues. Koha e plotësimit të një ankete ka zgjatur nga 5 deri në 10 minuta. Të dhënat janë analizuar me softuerin statistikor SPSS.³

Pyetësi është hartuar nga udhëheqësi i QHO-së në Universitetin AAB, Lulzim Pllana M.A., në bashkëpunim me prof. dr. Niko Tosh, udhëheqës i Qendrës për Hulumtimin e Opinionit dhe të Komunikimit Masiv në Lubjanë, dr. Slavko

* Lulzim Pllana, M.A., Universiteti AAB, Qendra për Hulumtimin e Opinionit-QHO

¹ www.cjm.si

² Shih Enti i Statistikave të Kosovës www.ks-gov.net/esk.

³ Statistical Programme for Social Science.

Kurdija, ligjërues në Universitetin e Lubjanës dhe bashkëpunor i kësaj të fundit.

Pyetësori përbehet nga pjesa fikse, që nënkupton të njëjtat pyetje në të gjitha fazat e anketimit, dhe pjesa e ndryshueshme, pyetje këto të cilat kanë të bëjnë me situata dhe ngjarje aktuale përgjatë periudhës kohore të anketimit.

Në përgjithësi, pyetësori parashihet përcaktimin dhe orientimin politik të opinionit publik rreth situatës politike, si dhe vlerësimin e saj dhe të ngjarjeve aktuale, sidomos të atyre politike, në Kosovë. Pos vlerësimit të institucioneve vendore, siç janë Qeveria, Kryeministria, Parlamenti, Policia, partitë politike, KLMDNJ, Sindikatat dhe Ombudspersoni, ai ofron mundësinë e vlerësimit të besueshmërisë jo vetëm në institucionet ndërkombëtare, siç janë Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, po dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Një vlerësim tjetër rreth besueshmërisë është edhe ai i medieve, duke e ndarë rëndësinë e vlerësimit të tyre në medie publike dhe private.

Si pyetje më e rëndësishme e pjesës fikse të „Barometrit politik“ është e ashtuquajtura „pyetja e së dielës“ ose „për cilën parti do të votoni“, që mund të trajtohen si thelbi i tij. Me qëllim krahasimi të pozicioneve dhe të përcaktimit të trendeve të partive politike, bëhet edhe pyetja: „për cilën parti keni votuar në zgjedhjet e fundit“. Si rrjedhojë e kësaj nxirret edhe një vlerësim për personalitetet politike, që bëhet nëpërmjet pyetjes së hapur. Kjo metodë e përcaktimit të vlerës bën që vendimet e marra të personaliteteve politike të mund të përcaktohen dhe të vlerësohen në bazë të aktiviteteve të tyre politike për një periudhë të gjatë. Ky vlerësim mund të plotësohet më mirë duke parashtruar pyetjen rreth ndryshimit apo jo të gjendjes në çështjet sociale, ekonomike, arsimore, shëndetësore etj. që nga zgjedhjet e fundit, domethënë të atyre të nëntorit të vitit 2007.

Pjesën e ndryshueshme të barometrit e përbëjnë ato pyetje që, varësisht nga situata aktuale, munden apo nuk munden të përsëriten në pyetësorin e barometrit. Pyetjet si „transformimi i TMK-së⁴ në FSK⁵“, „pikat e Ban Ki Moon-it“, „Plani i Ahtisarit“ ose „politika e Barak Obamës lidhur me Kosovën“ janë pyetje tipike të pjesës së ndryshueshme të barometrit.


⁴ Trupat Mbrojtëse të Kosovës.

⁵ Forcat e Sigurisë së Kosovës.

Pjesa empirike e barometrit ka të bëjë me analizimin e të dhënave, domethënë të rezultateve të hulumtimit.

1. Zhvillimi i demokracisë dhe gjendja materiale


Ndër pyetjet hyrëse të barometrit kanë qenë zhvillimi i demokracisë dhe gjendja materiale. Nga pyetja: „sa jeni të kënaqur me zhvillimin e demokracisë në Kosovë“, shihet që shumica e respondentëve nuk janë të kënaqur me zhvillimin e saj, duke qenë vetëm 32% e tyre të kënaqur me këtë gjendje. Më pak se 10% shprehin neutralitetin e tyre dhe nuk dinë nëse janë të kënaqur apo jo.



Burimi: QHO N= 876

Për sa i përket gjendjes materiale personale dhe të familjes, graf. nr.2 tregon që më shumë se gjysma e respondentëve (54,8%) nuk janë të kënaqur, një pjesë e konsiderueshme e mbetjes (41,4%), janë të kënaqur me gjendjen materiale, ndërsa një pjesë e vogël (3,8%), nuk kanë përgjigje.

Graf. 2 A jeni të kënaqur me gjendjen materiale tuajën dhe të familjes tuaj?



Burimi: QHO N= 876


2. Përkrahja e institucioneve dhe besimi ndaj tyre

Si pjesë e përgjithshme e barometrit politik është ajo e quajtur „përkrahja e institucioneve dhe besimi ndaj tyre“, domethënë ndaj institucioneve siç janë: Qeveria, Kryeministria, Parlamenti, partitë politike, Policia, KLMDNJ, Sindikatat dhe Ombudspersoni.

2.1. Përkrahja e Qeverisë

Sipas rezultateve të hulumtimit, përkrahja e Qeverisë është e ulët, duke qenë se shumica e respondentëve, 54,79%, nuk e përkrahin, kurse 41,44% i japin përkrahje. Vetëm 3,77% prej tyre nuk dinë nëse e përkrahin apo jo.

Graf. 3 A e përkrahni qeverinë aktuale?




Burimi: QHO N= 876

2.2. Besimi në Institucionet vendore

Në grafikun vijues të mëposhtëm janë paraqitur vlerësimet e respondentëve për besimin në Institucionet e Kosovës bazuar vetëm në përgjigjet pozitive.


Policia duket se prin për nga besimi, duke marrë 27,92% të totalit të besueshmërisë në institucionet, pason Kryeministria me 15,02%, pastaj Qeveria, KLMDNJ, Parlamenti, Ombudspersoni, Sindikatat dhe, në fund, partitë politike.

Graf. 4 Besimi në institucionet e Kosovës

Burimi: QHO N= 876

2.3. Besimi në institucionet ndërkombëtare

Edhe institucionet ndërkombëtare të pranishme në Kosovë u përfshinë gjatë anketimit në pyetjet për besueshmërinë ndaj tyre. Rezultatet që nxori hulumtimi, (Graf. 5), tregojnë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës zënë vendin e parë në besueshmërinë e shumicës së respondentëve. Bashkimi Evropian është i dyti, dukshëm me pak se SHBA, kurse Kombet e Bashkuara kanë përqindjen më të ulët të radhës. Kjo vjen si rrjedhojë e perceptimit të drejtë të aktualiteteve politike si dhe të sferave të tjera shoqërore në Kosovë.




Burimi: QHO N= 876

2.4. Besimi në media


Mediat duket se janë mjeti kryesor i komunikimit në Kosovë dhe besohet të jenë një kanal i rëndësishëm për shpërndarjen e mesazhit në tërë popullatën e Republikës së Kosovës. Besueshmëria ndaj tyre duket se është mjaft e lartë dhe mund të konstatohet që ato, mediet, kanë, sipas rezultateve të mëposhtme, një impakt të fuqishëm në shoqërinë kosovare. Sipas grafikonit del që shumica e respondentëve, mbi 65%, u besojnë atyre, 29% nuk u besojnë, kurse 8% nuk kanë dhënë përgjigje. Duke iu referuar përgjigjes pozitive rreth besueshmërisë dhe pyetjes: „cilave media u besoni?“ (Graf. 7), del që gati gjysma e tyre (49,43%) u besojnë medieve publike, kurse vetëm 24,66% e tyre u besojnë medieve private. Besimin në të dyja mediet e kanë vetëm 1,83% e respondentëve, ndërsa pa përgjigje kanë qenë rreth 24% e tyre.

Graf. 6 A u besoni medieeve?



Burimi: QHO N= 876

Graf. 7 Cilave medie u besoni?




Burimi: QHO N= 876

3. Pyetja e së dielës

Si faktor kyç për vlerësimin e barometrit është pyetja e së dielës. Qëllimi paraprak i kësaj pyetjeje ishte vlerësimi i gatishmërisë për të dalë në zgjedhje nëse do të mbaheshin të dielën e ardhshme.


Nga rezultatet (graf. 8) shihet që më shumë se 50% e të anketuarve do të dilnin në zgjedhje, ndërsa 37% e tyre nuk do të dilnin. Një pjesë e tyre, 10%, nuk janë ende të vendosur nëse do të dilnin apo jo.

Graf. 8 Nëse do të mbaheshin zgjedhjet të dielën e ardhshme, a do të dilnit në zgjedhje?



Burimi: QHO N= 876


Përgjigjet e pyetjes simulative të zgjedhjeve: „për cilën parti do të votonit?“, lënë të kuptohet (Graf. 9) që një pjesë e madhe e respondentëve, (28%), janë ende të pavendosur, çka do të thotë se çdo parti politike mund të pësojë ndryshime deri në zgjedhjet e ardhshme reale. PDK prin me 25% dhe zë vendin e parë, duke u ndjekur nga AAK me 15%, LDK me 14%, AKR me 5,5%, LDD me 5,15%, ORA me 2,41% dhe PD me 1,49%.



Burimi: QHO N= 876

Pyetjes: „për cilën parti keni votuar në zgjedhjet e fundit?“, qëllimi i së cilës ishte krahasimi i trendeve të tyre politike, respondentët i janë përgjigjur (shih Graf. 10) në atë mënyrë që tregon se ka një ulje të trendeve të të gjitha partive politike me përjashtim të AAK-së, e cila ka një tendencë të vogël rritjeje. PDK prin prapëseprapë, ndërsa ulje të dukshme të trendit ka LDK-ja, më saktësisht nga 20,42% zbrit në 14,3%, e cila ia lë kështu vendin e dytë AAK-së. Ata të cilët nuk kanë pasur përgjigje për këtë pyetje, kanë përbërë vetëm 14,19%.

Graf. 10 Për cilën parti keni votuar në zgjedhjet e fundit?




Burimi: QHO N= 876

4. Personalitetet politike

Me rastin e pyetjes vijuese, e cila kishte të bënte me vlerësimin e personaliteteve politike, respondentët përmendën më shumë se 120 personalitete. Pragu i vlerësimit të tyre në barometrin tonë është 2,5%, që përfshin gjithsej 12 personalitete të skenës politike kosovare. Kështu kryeministri Hashim Thaqi i prin listës së personaliteteve më të sukseshme me 15,64% duke u pasuar nga Fatmir Limaj, ministër i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit me 15,5%, pastaj nga Ramush Haradinaj, kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës me 13,98%, Fatmir Sejdiu, president i Republikës së Kosovës me 13,83%, Veton Surroi, publicist, me 8,25%, Nexhat Daci, kryetar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë me 7,46%, Enver Hoxhaj, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me 5,87%, Blerim Shala, nënkryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës me 4,71%, Bexhet Pacolli, kryetar i Aleancës Kosova e Re me 4,27%,

Jakup Krasniqi, kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës me 3,91%, Agim Çeku, kryetar i Partisë Socialdemokrate me 3,84% dhe Hajredin Kuçi, zëvendëskryeminister i Qeverisë së Republikës së Kosovës me 2,75%.




Burimi: QHO N= 876

5. Aktualitetet politike

Në pjesën e ndryshueshme të pyetësorit, si çështje e lidhur me aktualitetet e skenës politike, ishin, ndër të tjera, edhe pyetjet rreth „pikave të Ban Ki Moon-it“, „politikës së Barak Obamës“ në lidhje me Kosovën, „transformimit të TMK-së në FSK“ etj.


Përgjigjet e respondentëve në lidhje me 6 pikat e Ban Ki Moon-it tregojnë se gati gjysma e respondentëve janë pak të informuar, kurse vetëm 23% e tyre di më shumë. Nëse bëhet një krahasim mes të dhënave, del që 16,55% e tyre nuk janë aspak të informuar rreth pikave të Ban Ki Moon-it. Grafikoni Nr.13 tregon qartë se opinioni i publikut tonë është që Qeveria të mos i pranojë 6 pikat e Ban Ki Moon-it, kurse vetëm 6.85% prej tyre kanë mendim pozitiv.

Graf. 12 A jeni të informuar për 6 pikat e Ban Ki Moon-it?



Burimi: QHO N= 876


Graf. 13 Cili duhet të jetë pozicioni i Qeverisë së Kosovës ndaj 6 pikave të Ban Ki Moon-it?



Burimi: QHO N= 876

Çështje tjetër që ka të bëjë me aktualitetet në vend, është edhe përkrahja apo jo e transformimit të TMK-së në FSK. Një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve, afro 74%, kanë një mendim pozitiv për transformimin e TMK-së në FSK.-16% prej tyre nuk e përkrahin, ndërkaq vetëm 10% prej tyre nuk dinë.


Graf. 14 A e përkrahni transformimin e TMK-së në FSK?



Burimi: QHO N= 876

Pyetjes (Graf. 15) rreth politikës së presidentit të ardhshëm të SHBA-së, Barak Obama, lidhur me qëndrimin amerikan ndaj Kosovës, 56% e anketuesve iu përgjigjën duke pohuar që politika e tij nuk do ta ndryshojë qëndrimin ndaj Kosovës, kurse vetëm 17% prej tyre kanë mendim të kundërt, ndërkaq 25% nuk dinë fare gjë rreth kësaj çështjeje.

Graf. 15 A mendoni që politika e Barak Obamës do ta ndryshojë qëndrimin amerikan ndaj Kosovës?



Burimi: QHO N=876

6. Përfundim

Barometri politik i Qendrës për Hulumtimin e Opinioneve – QHO, si projekt i saj i parë hulumtues, është një hulumtim afatgjatë i opinionit dhe përfshin edhe shumë variabla të tjerë të hulumtimit që do të trajtohen dhe analizohen në publikimin e veçantë të Qendrës.

Për arsye të popullsisë së peregjistruar dhe mungesës së të dhënave, pikat e anketimit janë zgjedhur dhe shpërndarë në bazë të numrit të vendbanimeve, prandaj dhe nuk është bërë ponderimi i të dhënave.

Barometri politik si i tillë, i pari në Kosovë, arrin të japë një paqyrë të gjendjes politike, të hulumtojnë dhe vlerësojnë vendimet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare me synimin që të jetë një ciceron politik si për opinionin publik, ashtu dhe për institucionet, partitë apo personalitetet politike.

